



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura IV**

**Sesioni pranveror**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja Nr. 97

Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302

Prishtinë, më 02 Prill 2014, në orën 13:00.

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË**  
**DHE MIRËQENIE SOCIALE**

**Në mbledhje morën pjesë:** Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Hamza Balje, Flora Brovina Salihe Mustafa, Bahri Thaçi, Nazane Breca, dhe Faton Topalli.

**Munguan:** Gëzim Kelmendi.

**Të pranishëm:** Shpresa Haxhijaj, Koordinatore e Komisionit, Muhamet Bytyçi, Zyrtar i fushës.

**Mbledhjen e kryesoi,** Fikrim Damka, Kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

**RENDI I DITËS:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 25.03.2014;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Sigurimin Shëndetësor;
4. Formimi i grupeve punuese për Projektligjet në procedurë;
5. Të ndryshme;

*Kryesuesi, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Salihe Mustafa, propozoj që në pika 5, të ndryshme, të diskutojmë lidhur me Projektligjin për Veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për një amendament i cili po konsideroj se duhet të përmirësohet.*

*Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.*

## **2 . Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës: 25.03.2014;**

*Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së datës:25.03.2014.*

## **3. Shqyrtimi i Projektligjit për Sigurimin Shëndetësor;**

**Fikrim Damka** - Tha se ne si Komisioni e kemi proceduar raportin me Rekomandime tek komisionet e përhershme, ku deri me tani vetëm tri komisione e kanë shqyrtuar, Komisioni për Buxhet dhe Financa si dhe Komisioni për Integritet Evropian si dhe Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, të cilat nuk kanë dhënë ndonjë propozim Amendament, kanë dhënë rekomandimin që mund të procedohet për miratim në lexim të dytë. Andaj propozoj që të procedohet për Kryesinë e Kuvendit, me qëllim që në javën e ardhshme ty hyje në rend dite për seancën e radhës.

**Komisioni, Pas diskutimeve njëzëri miratoj raportin përfundimtar për Projektligjin për Sigurimin Shëndetësor, pa rekomandimin e Komisionit për Legjislacion.**

## **4. Formimi i grupeve punuese për Projektligjet në procedurë;**

**Fikrim Damka**, Tha të vazhdojmë me formimin e Grupeve Punuese për projektligjet të cilat janë në procedurë, që kanë kaluar leximin e parë në Kuvend.

**Komisioni**, pas diskutimeve formoi grupet punuese:

### **Grupi Punues:**

#### **PROJEKTLIGJI PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-019, PËR AFTËSIMIN, RIAFTËSIMIN PROFESIONAL DHE PUNËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA**

1. Flora Brovina – Kryesuese,
2. Nazane Breca – Anëtare,
3. Time Kadriaj – Anëtare.

### **Grupi Punues:**

#### **PROJEKTLIGJI PËR SHËNDETIN MENDOR**

1. Fikrim Damka – Kryesues,
2. Bahri Thaqi – Anëtarë,
3. Time Kadriaj – Anëtare,
4. Hamza Balje – Anëtarë,
5. Faton Topalli – Anëtarë,
6. Gëzim Kelmendi – Anëtarë.

### **Grupi Punues:**

#### **PROJEKTLIGJI PËR SHËRBIMIN MJEKËSOR EMERGJENT**

1. Nazane Breca – Kryesuese,
2. Salihe Mustafa – Anëtare,

3. Time Kadria – Anëtare,
4. Fikrim Damka – Anëtarë,
5. Faton Topalli – Anëtarë.

**Kryesuesi**, tha se grupet punuese qysh në javën e ardhshme mund të fillojnë me punën/takimin e tyre.

## **5. Të ndryshme.**

**Kryesuesi**, të kalojmë të pika e fundit të ndryshme, kemi propozimin që të diskutojmë për Projektligjin për Veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, urdhëroni znj. Salihe Mustafa.

**Salihe Mustafa**, tha se, kërkoj që të diskutojmë lidhur me Nenin 31, Lirimi nga pagesat administrative në shkollimin Universitar Publik, respektivisht Amendamenti 17, konsideroj se është përvjedhur një gabim teknik, ne si komision jemi pajtuar që në fund të paragrafit të shtohet teksti “*dhe fëmijët e tyre*”. përveç veteraneve luftëtar të përfitojnë lirim nga pagesat edhe fëmijët e tyre.

**Komisioni**, Pas diskutimeve njëzëri vendosi që ky gabim teknik i përvjedhur të kërkohet direkt në seance që të përmirësohet, Deputeti **Fikrim Damka** në emër të komisionit që të kërkojë përmirësimin e këtij gabimi teknik.

### **Amendamenti 17.**

**Në fund të nenit 31 të shtohet fjala: dhe fëmijët e tyre.**

#### **Neni 31**

#### **Lirimi nga pagesat administrative në shkollimin Universitar Publik**

Lirimi nga pagesat administrative në shkollimin Universitar Publik, është e drejtë të cilën mund ta realizojnë veteranët luftëtarë **dhe fëmijët e tyre.**

**Kryesuesi**, Ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje.

**E përgatiti:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit.**

**Kryetari i Komisionit**

---

**Fikrim Damka**